

NEWSLETTER

Shtator

**Karta e Studentit/
Albsig i Bashkohet Nismës
së Bashkisë së Tiranës
për Ndihmë të Studentëve**

**Mesazhi/ Albsig Uron
Nxënësit për Fillimin
e Vitit të Ri Shkollor**



PJESË E  KASTRATI GROUP



**Manjola Shukulli,
Ish-Studentja e
La Sapienza-s
që Menaxhon Policat
e Sigurimeve në Albsig.**

**Albsig, Oferta Specifike
me Çmime Simbolike
për Sigurimin e Studentëve
Jashtë dhe Brenda Vendlit**

**Fushata Albsig: Sigurimi
i Nxënësve dhe Studentëve,
Një Sfidë e Vështirë për Prindërit
dhe Një Kulturë Sigurimesh për të Rinjtë**

**Ornis Doko, 1 Riu
që Studion për Economics &
Business Management në Bayes
Business School, London, Tregon
Eksperiencën në Albsig Invest dhe
Mundësinë e Kthimit në Tiranë**

**Afatet/ Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i
Teknologjisë, Deri në Fund të Tetorit me Dyer të Hapura për Studentët**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





 **ALBSIG**

PJESË E  KASTRATI GROUP

Sigurimi i Studentit Jashtë Shtetit

-30%
për blerjet online

Albsig, Oferta Specifike me Çmime Simbolike për Sigurimin e Studentëve Jashtë dhe Brenda Vendit

Paketa specifike me çmime simbolike, tashmë Albsig ka përgatitur për të gjithë studentët që do të nisin studimet brenda dhe jashtë vendit. Nëse po planifikoni të studioni jashtë vendit në një shkollë ose universitet ndërkombëtar, do t'ju kërkohet si nga shkolla juaj ashtu edhe nga vendi juaj pritës që të keni sigurim adekuat të studimit jashtë vendit për studentët, kur jeni duke vizituar. Shpenzimet mujore të studentëve rezultojnë mjaft të larta në krahasim me të ardhurat e tyre, duke u kthyer në një sfidë për përballimin e jetesës.

Gjatë muajit të fundit, nga ana e të rinjve, që do ndjekin studimet jashtë vendit është rritur ndjeshëm kërkesa për t'u pajisur me sigurimin e shëndetit. Pikërisht, ky interes ka shkaktuar reaksion ndërmjet shoqërive të sigurimit, disa prej të cilave nuk ngurrojnë të aplikojnë çmime preferenciale me shitjen e primeve. Periudha Korrik-Tetor shënon edhe nivelin më të lartë të shitjeve të kësaj police, duke i bërë më aktive të gjitha shoqëritë në treg.

Sa kushton ky sigurim?!

Primi i sigurimit të shëndetit është i ndryshëm për të rinjtë që studiojnë brenda vendit dhe për ata që studiojnë jashtë vendit. Kjo për shkak të kostove më të larta të pagimit të dëmeve në një vend të huaj. Primi i sigurimit vendoset në varësi të shtetit ku do të shkojë studenti, si dhe të periudhës për të cilën ai dëshiron të sigurohet. Njëkohësisht edhe në varësi të kushteve të kërkuara nga shtetet përkatëse. Sigurimi i Studentëve Jashtë Vendit është një sigurim që i vjen në ndihmë çdo të riu që nis periudhën e studimeve jashtë. Nëse keni vendosur të studioni jashtë vendit, keni bërë një zgjedhje sa të rëndësishme, aq edhe të kushtueshme. Tarifat shkollare pavarësisht se përbëjnë një investim të konsiderueshëm në të ardhmen tuaj, janë një shpenzim i madh dhe Sigurimi i Shëndetit Jashtë Vendit, ju mbron nga humbje të rënda financiare në rast emergjencash.

Pajisja me Sigurimin e Studentit Jashtë Vendit bën të mundur mbrojtjen jo vetëm të studentëve por edhe të financave të familjeve të tyre. Është e rëndësishme njohja me detaje e të gjitha të dhënave të policës së sigurimit më të cilën pajiset çdo i ri që nis shkollimin jashtë vendit. Sigurimi i Studentëve Jashtë Vendit është pasaporta e garancisë që merr me vete çdo i ri. Albsig ofron opsionet më të mira të sigurimit të shëndetit të studentëve në mënyrë që të merrni vendime të zgjuara për shëndetin dhe sigurinë tuaj personale nëse jeni studentë jashtë vendi dhe keni nevojë të paguani për trajtimin mjekësor, apo riatdhesimin urgjent.

Sigurimi i Studentëve Jashtë Vendit përfshin shpenzime për ndihmën mjekësore urgjente me mbulim 100% (përfshirë Covid-19). Dëmshpërblim në rast të humbjes së jetës nga aksidentet dhe shpenzime për riatdhesim. Dhe jo vetëm kaq, por mbulon dëmet si sëmundje akute, aksidente, deri në humbjen e jetës.



albsig.al 

Pajisuni me Sigurimin e Studentit Jashtë Shtetit dhe Albsig ju vjen në ndihmë në mënyrë të menjëherëshme për:

- Shpenzimet mjekësore;
- Dëmshpërblim në rast të humbjes së jetës nga aksidentet;
- Shpenzime për riatdhesim.



Mesazhi/ Albsig uron nxenesit per fillimin e vitit te ri shkollorë

Albsig i uron suksese të gjithë nxënësve për vitin e ri shkollor 2022-2023!

Dituria është fuqi! Prandaj çdo nxënës ka nevojë për siguri gjatë gjithë rrugëtimit të dijes.

"Gëzuar vitin e ri shkollor, suksese e rezultate më të larta në mësimet. Urimet më të përzemërta për vogëlushet e vogëlushët për të cilët kjo ditë do të gdhendet për jetë në kujtesën e tyre si dita e parë e shkollës. Rrugë të mbarë në fushën e bukur të diturisë!", janë fjalët me të cilët nis mesazhi i urimit për vitin e ri shkollor nga Drejtuesit e Shoqërisë së Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati grup.

Njekohesisht një urim të vecantë nuk le pa dhënë për mesuesit e të gjitha shkollave. "Të nderuar mësues, punë të mbarë e suksese në vitin e ri arsimor. Ju keni fatin të punoni që shkolla shqiptare të ecë me hapin e vendeve më të përparuara. Arsimi është pararoja e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ju uroj të gjithëve, mësues e nxënës, të dilni faqebardhë në këtë vit të ri shkollor, të keni ritmet që ju bëjnë juve dhe të gjithë neve, krenarë për arsimin shqiptar sot. Uroj për nesër një ditë të gëzuar për të gjitha familjet shqiptare", përfundon mesazhi i urimit.

Ju rikujtojmë se Albsig ofron paketën e sigurimit të nxënësve, për një vit të mbarë shkollor!
Na kontaktoni për çdo informacion ose vizitoni faqen tonë të internetit www.albsig.al.

”

Siguria e fëmijëve tuaj, Prioriteti Ynë!

I mbaruat përgatitjet për vitin e ri shkollor? Po Sigurimin e Nxënësve e keni blerë? Keni menduar një buxhet specifik dhe thuajse simbolik për shendetin e fëmijëve Tuaj. Albsig ju mbron fëmijet nga aksidentet brenda dhe jashtë ambienteve shkollore.

Sigurimi i Nxënësve u mundëson prindërve mbështetje financiare në rast sëmundje apo aksidenti të fëmijës përgjatë gjithë vitit shkollor. Kjo police gjithashtu, synon të krijojë një kulturë sigurimesh për gjeneratat e reja.

ÇFARË PËRFSHIN:

- Shpenzimet e trajtimit mjekësor në të gjitha entet shëndetsore;
- Shpenzime për medikamentet mjekësore;
- Paaftësinë e përhershme të plotë ose të pjesshme;
- Vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti, etj.

DËMET E MBULUARA:

- Helmimi akut;
- Mbytja;
- Ngrirja;
- Goditja dhe djegia nga rrezet e diellit;
- Dëmtime të shkaktuara nga sforcime fizike
- Asfiksia, etj.

Albsig,
vlerat që na bashkojnë!



Si Superheronj...

ME SIGURIMIN E NXËNËSVE

PËR VETËM

500

lekë/vit





Fushata Albsig: Sigurimi i Nxënësve dhe Studentëve, Një Sfidë e Vështirë për Prindërit dhe Një Kulturë Sigurimesh për të Rinjtë

Tashmë kanë kaluar javën e dytë të mësimit dhe nxënësit e të gjitha shkollave në vend janë stabilizuar me të gjitha problematikat e fillimit të vitit të ri akademik 2022–2023. Ajo që të bie më shumë në sy është kërkesa e ulët e nxënësve për t'u siguruar, fenomen ky i hasur sidomos në shkollat profesionale, kërkesë kjo që është e detyruar për t'u pajisur me këtë kontratë sigurimi. Por, pasi një pjesë e mirë e tyre nga përvoja e viteve të mëparshme janë hasur me shumë sfida shëndetësore, të cilat fatkeqësisht janë të papritura. Në shoqërinë shqiptare ende ka një ndërgjegjësim shumë të ulët sa i përket sigurimit të nxënësve dhe studentëve, duke e lënë tërësisht në dorë të fatit të ardhmen e tyre shëndetësore.

Albsig, fushatë të dedikuar për shkollat.

Shoqëritë e sigurimeve ofrojnë paketa specifike me çmime simbolike për sigurimin e nxënësve dhe studentëve, duke tentuar t'ia heqin prindërve “barrën” e kostove shëndetësore dhe duke u lënë vetëm atë të arsimimit. Por megjithatë, janë prindërit ata që nuk mendojnë mjaftueshëm në këtë drejtim, për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Është viti i pestë që Albsig starton fushatën për sigurimin e nxënësve nëpër shkollat e të gjithë vendin, ku kërkesën më të madhe e mban qyteti i Tiranës, duke patur numrin më të madh të shkollave profesionale. Konkretisht, Albsig.sh.a ofron Sigurim e Nxënësve për një periudhë 1 vjeçar me një vlerë mesatare simbolike prej 500 lekësh. Kontrata e sigurimit është hartuar e dizenuar me synimin që të ofrojë për prindërit një mbështetje financiare në rast sëmundje apo aksidenti të fëmijës, gjithashtu dhe për të krijuar një kulturë sigurimesh tek brezi i ri. Nderkaq, Albsig ka ngritur grupin e punës për të menaxhuar në disa shkolla situatën e nxënësve. Çdo shkollë është e pajisur me standat përkatëse ku çdo nxënës merr udhëzimet dhe në fund pajiset me sigurimin e kërkuar.

Fushata në emër të nxënësve.

“Është viti i pestë që të gjitha shoqëritë e sigurimeve janë sensibilizuar për të krijuar sadopak një kulturë mbi rëndësinë e sigurimeve. Kjo duket tek ndërgjegjia e të rinjve që sa vjen dhe shtohet kundrejt fenomenit për t'u siguruar. Një pjesë e profesioneve e kanë të domosdoshme të jenë të mbrojtur përgjatë gjithë vitit akademik”, kështu nis të tregojë mësuese Irena Fishta. Kjo e fundit, tregon se vështirësia për të bindur haset më shumë tek vitet e para, pasi këta të fundit nuk janë të pajisur me këtë lloj sigurimi. Jo vetëm kaq, por njëkohësisht një pjesë e mirë e nxënësve janë ndikuar nga përvojat e bashkëmoshatarëve të tyre dhe tani janë të njohur me rëndësinë e të pajisurit me një kontratë sigurimi.

“Ne bëjmë sqarimin e rëndësisë së kontratave të sigurimit për secilën klasë apo për secilin nxënës, më pas janë nxënësit ato që paraqiten pranë stendave të shoqërive të sigurimeve dhe bëjnë konkrete blerjen e siguracionit. Aktualisht janë të gjitha shoqëritë e sigurimeve prezente, por ajo që është më dominuese në shkollën tonë është Albsig. Staf i tyre sqaron me përpikmëri çdo nxënës që shkon pranë stendave të tyre dhe më pas i pajis ato me siguracionet e kërkuara, të cilat janë hartuar në mënyrë të tillë për t'i ardhur në ndihmë të gjitha target grupeve të popullsisë.”, tregon mësuese Fishta.

Albsig i Bashkohet Nismës së Bashkisë së Tiranës për Ndhimë të Studentëve



Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Grup, i është përgjigjur pozitivisht thirrjes së Bashkisë së Tiranës drejtuar bizneseve dhe kompanive të ndryshme private për të kontribuar me shërbime që do të ofrohen falas apo me pagesë të reduktuar studentëve të universiteteve të Tiranës nëpërmjet Kartës së Studentit. "Albsig.sh.a", një nga Shoqëritë e Sigurimeve që ofron sigurime, jo vetëm për studentët, por dhe familjarët e tyre, iu bashkua kësaj nisme dhe të gjithë studentët që janë pajisur me kartë studenti do mund t'i përfitojnë produktet e Albsig me një ulje të konsiderueshme në çmim. Nëse keni Kartën e Studentit, ejani në Albsig dhe zbuloni uljet mbi ulje të dedikuara vetëm për ju studentë të dashur.



Në këtë periudhë të jesh student në Shqipëri është një sfidë, këtë të gjithë e pranojmë. Është mirë që çdo student të ketë partnerin e tij të sigurisë që ta ndihmojë duke i ofruar lehtësira që në hapat e para të jetës studentore jashtë familjes. Albsig, lider në tregun e sigurimeve, ka përqaftuar projektin e iniciuar nga Bashkia e Tiranës në Janar 2021 për të mbështetur studentët duke u ofruar çmime preferenciale vetëm për ata që janë mbajtës të Kartës së Studentit.

Janë mbi 36,000 të rinj dhe të reja që kanë përfituar nga kjo paketë me çmime preferenciale. Për ju që nuk na keni vizituar ende, ne themi hajde në Albsig dhe merr ULJE EKSTRA. Sigurimet e nxënësve, studentëve brenda dhe jashtë vendit, sigurimet e makinave, sigurimet e shëndetit dhe të pronës për ju dhe familjarët tuaj, Albsig ka menduar një sërë uljesh si më poshtë.

Lista e Shërbimeve

Sigurim i Aksidenteve dhe Sëmundjeve

Sigurim i Nxënësve dhe Studentëve
Sigurim Shëndeti
Sigurim Shëndeti në Udhëtim

Sigurim i Mjeteve Motorike i Detyruar

Sigurim i Mjetit Motorik për Përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (TPL)
Kartoni Jeshil
Sigurimi Kufitar i Mjetit Motorik

Vullnetar

Sigurim Mjeti Kasko
Sigurim Mjeti Mini-Kasko

Sigurim i Pasurisë për Studentët dhe Familjarët e Tyre

Sigurim nga Zjarri, Tërmetet dhe Rreziqet Shtesë
Sigurim nga Vjedhja

Oferta e Reduktuar (Oferta për studentët)

30% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

15% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

20% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

40% zbritje nga primi i miratuar i shitjes

Albsig ka qenë dhe është përfshirë gjithmonë në nisma të tilla të përgjegjësisë sociale. Studentët e siguruar të sotëm janë profesionistët e së ardhmes dhe ne jemi të bindur që çdo ndihmë sado e vogël për ta sot, do të na kthehet shumëfish nesër. Karta e Studentit është mjeti nëpërmjet të cilit studentët përfitojnë mjaft avantazhe, tarifa të reduktuara dhe oferta të dedikuara, si nga institucionet publike, ashtu edhe nga subjektet private.

Pajisja dhe paraqitja e kartës është e detyrueshme nga ana e çdo studenti për përfitimin e këtyre avantazheve. Në rrjetin e shërbimeve publike, me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Publike", paraqitja e kartës është e mjaftueshme. Në rrjetin e shërbimeve private partnere të grupuara në platformën "Karta Extra", me të cilin mund të njiheni duke klikuar mbi ikonën "Shërbime Private", studentët përfitojnë uljet dhe ofertat e dedikuara për ta, në formë pikësh të ngarkuara në kartë nëpërmjet leximit të saj nga sistemi (jo thjesht paraqitjes së kartës) që përdor secili prej aktiviteteve private.

Këto pikë të grumbulluara, studenti kartëmbajtës mund t'i përdorë si vlerë monetare për të realizuar çdo lloj blerje në të gjithë rrjetin e këtyre subjekteve private, të cilët i janë bashkuar nismës së Bashkisë Tiranë.





Manjola Shukulli

**Ish-Studentja e La Sapienza-s
që Menaxhon Policat e Sigurimeve në Albsig**



Është cilësuar si një ndër punonjëset me strikte për moshën që ka. Vitet e përvojës më shumë se 10 vjeçare në Albsig kanë bërë që ajo tashmë të quhet profesioniste në fushën e administrimit të policave. Është ndër financiarët më konçize dhe më të sakta, pasi bën të mundur rakordimin e përmuajshëm të të gjitha policave të sigurimit që Albsig gjeneron. Do të shtoja gjithashtu se sfida më e madhe për të ishte koha e shkurtër në dispozicion për çdo veprim apo vendimarrje, çka ishte në disfavorin e saj, ashtu si dhe risku i lartë i kthimit në atdhe/të panjohurës që e priste, përkundrajt ndjenjës së lartë të përgjegjshmërisë e objektivit për të mos e ndërprerë në asnjë moment qëllimin që kishte dhe përkushtimin për punë. Për sa më sipër, kombinimi i investimit të familjes, të udhëhequr nga vlerat më të forta të përgjegjshmërisë, angazhimit, dinamizimit, fleksibilitetit, miksuar me inovacion teknologjik në Albsig, bënë të mundur që t'ja dilte për të mos i ndërprerë ëndrrat e saj duke ju shërbyer klientëve. Bëhet fjalë për Manjola Shukullin, financieren e Albsig, e cila do të na tregojë me detaje periudhën e studimeve në universitetin e La Sapienza në Romë, kthimin në atdhe dhe përvojën e përfituar prej më shumë se 10-viteve në Albsig.

Keni studiuar për ekonomi, dega Financë në Universitetin më të mirë në Itali, kjo degë ishte ëndrra juaj apo detyrim i kohës?

Çfarë do të thotë të prekësh ëndrrën? Emocion i papërshtueshëm, një vlerësim i jashtëzakonshëm, një ndjesi gati-gati e pabesueshme. Sado i madh të ishte besimi në vetvete mbështetur në rezultatet e arritura ndër vite dhe mbështetjen familjare, shanset reale ishin shumë të pakta dhe nuk mjaftonin për të krijuar siguri që mund të jesh një nga studentët që pranohen për të vazhduar studimet në universitetin më të mirë në botë, sië është Univeristeti La Sapienza në Romë. Ndiej që çdo përpjekje dhe çdo vështirësi më është shpërblyer maksimalisht. Kjo dëge ka qenë ëndrra ime që në gjimnaz, që mes shumë përpjekjesh arrita ta bëja realitet.

Cilat ishin lëndët që pëlqeje në shkollë të mesme dhe si i prite studimet në këtë degë dhe në fakultetin "La Sapienza" Romë, në Itali?

Krahas talentit dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të arritur rezultate sa më të larta përgjatë gjithë viteve të studimit, ka qenë puna e vazhdueshme dhe sistematike ajo që e ka kurorëzuar me sukses çdonjërin prej viteve, që nga shkolla 9-vjeçare e deri në vitin e fundit të gjimnazit. Në Shqipëri ka me qindra maturan të dhe studentë të shkëlqyer, që bëjnë sakrificë maksimale për të arritur më të mirën, për të patur një formim sa më cilësor, secili prej tyre mund të ishte në vendin tim. Janë ata dhe familjet e tyre që sakrifikojnë gjithçka për edukimin cilësor. Kam qenë nxënëse shumë e mirë në lëndët shkencore, veçanërisht në Matematikë. Më pëlqenin dhe gjuhët e huaja, Italisht dhe Anglisht. Edhe në italisht kam qenë me rezultate shumë të mira. Ishte ëndrra ime të studioja në një universitet jashtë Shqipërisë dhe sidomos në Itali pasi njihja mirë gjuhën italiane.

Sa ka ndikuar familja dhe shoqëria në zgjedhjen tuaj mbi degën dhe a mendoni se keni bërë zgjedhjen e duhur?

Në të vërtetë u jam më tepër se mirënjohëse prindërve të mi që kanë qenë një model perfekt për t'u ndjekur dhe që më kanë qëndruar pranë gjatë hapave më të rëndësishme të formimit tim intelektual.

Por, për sa i përket zgjedhjes së degës, ata thjesht më kanë dhënë këshilla me shumë vlerë, duke u përpjekur të mos më imponojnë në asnjë formë mendimin e tyre. Të njëjtën gjë mund të them

edhe për shoqërinë. Të gjithë e kanë respektuar zgjedhjen time dhe, si prindërit, ashtu edhe shoqëria, më kanë forcuar besimin se zgjedhja që kam bërë ishte e duhura.

Me të mbaruar fakultetin u kthyet në Shqipëri dhe u futët direkt në punë?

Si çdo student që mbaron jashtë atdheut ëndërron që kthimi të jetë në vendin e tij. Ashtu dhe për mua rrugët e karrierës filluan të hapeshin dhe unë vendosa menjëherë të ze vend në Shqipëri. Pas praktikave të shumta që kisha bërë e ndihmuar nga shkolla, arrita të ze punë si financiere në një nga shoqëritë e sigurimeve në qytetin tim të lindjes, në Korçë.

Në Albsig është përvoja juaj e parë apo keni punuar që në fillim në fushën e sigurimeve?

Pasi mora të gjithë përvojën e duhur në një nga kompanitë shoqëritë e sigurimeve në qytetin tim të lindjes, në Korçë, vendosa që të vij me punë në Tiranë. Pasi mora njoftimin e vendit të lirë të punës në Albsig, u përgatita që të merrja pjesë në konkursin e hapur për punë që kompania kishte bërë thirrje. Kam konkuruar për financiere në Albsig dhe pasi më panë që unë kisha përvojë në këtë fushë dhe kisha dhe arsimin përkatës e fitova vendin e punës.

Sa vite përvojë keni në sigurime dhe si e shikoni ju këtë fushë? Mendoni se femrat janë më strikte dhe më të prirura në këtë fushë?

Sigurimet janë tregu që sa vjen e po zhvillohet. Vitet e fundit duket se ka një qasje shumë pozitive tregu i sigurimeve tek konsumatorët. Një pjesë e mirë e konsumatorëve janë ndërgjegjësuar për sa i përket rëndësisë së sigurimeve. Me rënjen e dy tërmete të vitit 2019 dhe Pandemisë së Covid-19 shumë njerëz janë ndërgjegjësuar mbi rëndësinë që tashmë kanë pjesa më e madhe e sigurimeve.

Në Albsig kam më shumë se 10 vjet që punoj me përkushtim dhe ambicje për të ardhmen. Fusha që kam përzgjedhur është shumë delikate sepse duhet kontrolluar çdo detaj mbi policën e sigurimeve dhe duhet rakorduar brenda ditës çdo problematikë e hasur dhe deri tani mendoj që ja kemi dalë me sukses. Për këtë, duke u bazuar në përvojën që kam deri tani, mendoj se femrat mund të jenë shumë të zonja edhe në fushën e sigurimeve.

Ju jeni në njësinë e administrimit të shitjes së policave. Si e shikoni këtë hallkë dhe sa e rëndësishme është për kompaninë?

Mendoj se është një ndër hallkat më të rëndësishme në kompani, edhe pse unë personalisht kam qenë më e prirur si financiere dhe aty kam dashur të punoj në fillim, administrimin e policave e kam shumë primar. Nga mirëmenaxhimi i administrimit të policave të sigurimit përmbillen shumë problematika që prekin çdo hallkë të shoqërisë. Dhe këtë pjesë ne si staf në Albsig e përmbylim për çdo muaj me sukses, ku çdo problematikë merr zgjidhje.

Nëse dikush kërkon të punësohet pranë një institucioni financiar siç janë shoqëritë e sigurimeve në këtë periudhë, çfarë këshillash do t'i jepnit?

Edhe pse në Shqipëri mungon edukimi mbi sigurimet, sërish duket që ka marrë një hov të madh kjo fushë. Është një ndër tregjet financiare që premtan një të ardhme shumë shpresëdhënëse. Ndërkaq, për sa i përket profilin të punësimit, është një fushë që të jep shumë mundësi për t'u rritur profesionalisht në të ardhmen, por që kërkon dhe impenjim.

Afatet/ Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, Deri në Fund të Tetorit me Dyer të Hapura për Studentët

Grupi KASTRATI sjell në Shqipëri përvojën gjermane të arsimit dual profesional.

Apliko tani, nëse dëshironi të bëheni pjesë e një prej programeve që Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë ofron. Afatet e aplikimit dhe të regjistrimit do të jenë deri në fund të muajit Tetor. KPGJT, është Garancia për Tregun e Punës! Për të gjithë studentët “e pavendosur” që ende nuk kanë marrë vendimin përfundimtar të përzgjedhjes së profesionit, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë është zgjedhja e duhur. Kolegji do të jetë i hapur për regjistrim deri në fund të muajit Tetor. Kolegji është një mundësi e mirë për studentët pasi hap një derë të re për të ardhmen e tyre. Së bashku me profesorët e huaj dhe mundësia praktikës në firmat më me zë në Shqipëri, Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë është e ardhmja e arsimit! Bazuar në Sistemin Dual të Arsimit, ky kolegji sjell pedagogë dhe ekspertë të huaj për secilën nga programet, duke zbatuar praktikatat më të fundit dhe moderne Evropiane.

Edhe shkollë edhe punë. Tashmë vetëm në Kolegjin Profesional të Lartë Gjerman të Teknologjisë mund të përfitonit nga kjo përvojë. Për herë të parë të rinjtë do të kenë mundësi të praktikohen direkt në fushat që ato kanë përzgjedhur për t'u perfeksionuar. Tashmë, kanë startuar regjistrimet për në Kolegjin Profesional të Lartë Gjerman të Teknologjisë, i cili do të përgatisë profesionistë të kualifikuar të Teknologjisë së Automobilitëve, Elektromekanikës, Elektronikës, Menaxhimit të Ndërtimit, Elektrikës si dhe të Sistemeve të Ajrit të Kondicionuar.



KPGJT, është nismë e Grupit KASTRATI si përgjigje e nevojës tepër të madhe të tregut të punësimit për profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë pune në fushën e teknologjisë. Risia e këtij kolegji profesional është metoda e arsimit dual; ndërthurja e teorisë me praktikën; gjë e cila garanton punësim të menjëhershëm pas përfundimit të shkollës. Përfitimet e studimit në këtë kolegji nuk mbarojnë me kaq. Bizneset e Grupit KASTRATI venë në dispozicion hapësirën dhe mjetet e nevojshme për praktikën e studentëve dhe janë të parët që do të mirëpresin të diplomuarit duke iu ofruar punë në kompanitë e tyre.

Modeli gjerman i arsimit profesional tregon se tranzicionet më të mira dhe pa probleme ndodhin kur punëdhënësit janë të përfshirë në hartimin e kurseve profesionale dhe ku mësimi teorik në shkollë kombinohet me përvojën e punës praktike në formën e saj mësimore. Gjermania renditet e para në Evropë për sa i përket inovacionit në ekonomi, industri e më gjerë dhe Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë sjell në Shqipëri pikërisht atë metodë arsimore që ka kaluar me shumë sukses provat e ekonomisë globale.

Vendet me një integrim më të lartë mes shkollës dhe punës, shfaqin një tranzicion më të butë dhe më të shpejtë për të rinjtë. Kjo arrihet përmes programeve të praktikës ose përmes numrit më të madh të të rinjve që kombinojnë efektivisht shkollën dhe përvojat e hershme në tregun e punës.



Pse duhet të jeni pjesë e Kolegjit Profesional të Lartë Gjerman të Teknologjisë?

Rëndësia e shkollave të tilla profesionale në vendin tonë është tepër e madhe, pasi ndihet një mungesë e theksuar e fuqisë punëtore me aftësi profesionale teknike ndërkohë që bizneset shqiptare synojnë të arrijnë nivelet dhe standardet bashkëkohore. Për më tepër, edhe vetë



Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, e ardhmja e të rinjve në duart tuaja.

Profesionet e ëndërruara për të rinjtë tashmë do të bëhen realitet vetëm duke u bërë pjesë e KPGJT. Jo vetëm kaq, por Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë synon që kompanitë e vogla dhe të mesme të përfitojnë teknikë të mirëkualifikuar, me përvojë të pasur, që janë fleksibël dhe më të adoptueshëm në sfidat e reja ekonomike dhe që reagojnë pozitivisht ndaj ndryshimeve të tregut në Shqipëri.


Kolegji më i ri profesional në Shqipëri do të ofrojë programe një dhe dy vjeçare studimesh, si dhe kurse trajnimi me afate 3-6 mujore. Programi mësimor do të përmbajë praktika profesionale të garantuara në biznese me standarde evropiane si Auto Star Albania, përfaqësuese e Mercedes-Benz në Shqipëri, si dhe ndërmarrje me standardet më të larta të Fushës së Ndërtimit dhe Teknologjisë së Informacionit, pjesë të Grupit KASTRATI. Shkolla ofron mësimin me pedagogë dhe ekspertë nga Gjermania, Zvicra, Austria, etj, të cilët do të përdorin kurrikula të përditësuara sipas standardeve evropiane.

kompanitë kanë dëshirë të trajnojnë dhe zhvillojnë aftësitë e stafit të tyre, por mungesa e bashkëpunimit, e informacionit dhe pamundësia e përballimit të kostove ka bërë që një praktikë e tillë të mos ekzistojë thujse fare. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, përveç përgatitjes së një stafi të kualifikuar teknik, do t'i vijë në ndihmë edhe kompanive të tjera në vend që do të kenë dëshirë për të trajnuar dhe aftësuar stafin e tyre, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe duke dhënë kontribut domethënës në zhvillimin profesional të vendit. Kolegji Profesional i Lartë Gjerman i Teknologjisë, është tashmë në proces akreditimi dhe do të ofrojë programe studimi të mbështetura në përvojën dhe praktikën më të mira të vendeve evropiane dhe sipas kritereve të sistemit të Bolonjës, të vlerësuara me ECTS. Studentët e këtij kolegji do të kenë në dispozicion teknologjinë më të fundit në të gjitha fushat ku do të përgatiten, me laboratorë mësimorë, si dhe me praktikën në terren në disa prej bizneseve më të suksesshme në Shqipëri. Nisma e Grupit KASTRATI për hapjen e një shkolle të tillë profesionale ka ardhur nga bindja se sistemi i bashkëpunimit me bizneset, i futjes së tyre në shkollë dhe lidhja e studentëve me vendin e mundshëm të punës, është çelësi i gjithë ndryshimit, si për studentët që dëshirojnë të kenë garanci punësimi, ashtu edhe për bizneset që kërkojnë profesionistë të nivelit të lartë.

S'ka teori pa praktikë dhe s'ka praktikë pa teori!

Kjo është motoja e Kolegjit Profesional të Lartë Gjerman të Teknologjisë, i cili do të nisë shumë shpejt të përgatitjes profesionistët e të ardhmes.

Për më shumë informacion mbi kolegjin dhe mënyrën e aplikimit, mund të vizitoni www.kpgjt.edu.al apo të kontaktoni në info@kpgjt.edu.al ose +355 69 60 99 099.





Ornis Doko, i Riu që Studion për Economics & Business Management në Bayes Business School, London, Tregon Eksperiencën në Albsig Invest dhe Mundësia e Kthimit në Tiranë

Edhe pse ka kaluar një periudhë të konsiderueshme në Mbretërinë e Bashkuar sërish mendjen dhe zemrën e ka në atdhe, Shqipëri. Është një ndër studentët më të përgatitur që tashmë është në master për Management në Londër. I përkushtuar në fushën e financave, i shkathët dhe kurajoz të ndërmarrë iniciativa të rëndësishme për profesionin e tij, këmbëngulës dhe iniciator për të bërë ndryshimet e duhura, jo vetëm në shkollim dhe kualifikimet që merr, por dhe në mesazhet që jep për bashkëmoshatarët e tij. Bëhet fjalë për Ornis Doko, i riu nga Tirana, i cili po mbaron studimet dhe po merr kualifikimet e duhura në Mbretërinë e Bashkuar. Në një rrëfim ndryshe tregon kalvarin e vështirësive dhe triumfin e një jete në vend të huaj. Kohën e pushimeve e ka shfrytëzuar për të marrë sa më shumë informacion rreth profesionit të tij dhe ka ushtruar praktikë pune gjatë kësaj kohe në Albsig Invest.

1. Ju keni zhvilluar praktikën në Albsig Invest, a mund të më tregoni pse keni shprehur interesin tuaj të jeni pjesë pikërisht e kësaj shoqërie?

Fillimisht dua ta marr këtë mundësi t'ju falenderoj për këtë eksperiencë që më dhatë në Albsig Invest. Interesi im që të jem pjesë e kësaj shoqërie filloi duke parë çfarë mungon në Shqipëri dhe si mund ta përmirësojmë ne si shoqëri. Duke parë çfarë bën Albsig Invest, mendova që është rruga e duhur dhe diçka interesante për mua që ta studioj dhe të përfshihem më shumë. Ndërkohë, kjo lidhet dhe me fushën për të cilën po studioj dhe më ndihmon.

2. Si aplikuat në Albsig dhe a kishit vështirësi në përfitimin e praktikës?

Në Albsig më shumë pashë online dhe studiova fushat e ndryshme që kjo shoqëri ofronte. Duke parë dhe duke kontaktuar punonjës të Albsig, mu dha mundësia që të jem pjesë e grupit të Albsig Invest.



3. Çfarë studioni konkretisht në Mbretërinë e Bashkuar?

Unë studioj për Economics & Business Management në Bayes Business School, Londër. Kam kaluar 6 vite në Londër duke bërë gjimnazin fillimisht dhe më pas universitetin. Tani do bëj master për Management në universitetin ku përfundova dhe mora Bachelor Degree.

4. Duke pasur parasysh faktin se më herët nuk keni patur përvojë në këtë fushë, a e patët të vështirë qasjen tuaj dhe a e keni me pasion?

Fillimi është gjithmonë pak sfidues, por mendoj që kjo e bën më interesante. Por me ndihmën e z. Elton Korbi dhe stafit, u ambientova me fushën dhe me njerëzit rreth meje. Duke takuar individ të ndryshëm dhe duke vizituar institucione të ndryshme, me krijoi mundësi që të kisha një rritje nga ana profesionale dhe e njohurive.

5. Në këndvështrimin tuaj, si e shihni realitetin shqiptar dhe veçanërisht gjendjen e rinisë sot? A janë ata në udhën e duhur?

Për mendimin tim, rinia sot është në udhën e duhur. Pavarësisht opinionit të përgjithshëm të krijuar negativisht për rininë, unë e mendoj ndryshe. Rinia sot, është një rini që pretendon dhe kërkon nga vetja më shumë për të arritur qëllimet e veta dhe për t'u bërë dikush në jetë. Ndërkohë, i kanë të gjitha mundësitë, si brenda vendit, por edhe jashtë sepse dyert janë të hapura për këdo.

6. Ku e shikoni veten tuaj në të ardhmen, do ktheheni në Shqipëri apo do vazhdoni aktivitetin tuaj në Mbretërinë e Bashkuar?

Idetë e mia të para ishin që të kryej studimet dhe të marr kualifikimet e duhura në Mbretërinë e Bashkuar. Në fillimet e shkollës e shikoja të ardhmen atje, por tani duke parë që në Shqipëri hapësirat dhe mundësitë, si për të punuar dhe si për të investuar, janë të shumta, e shikoj si mundësi për t'u kthyer.

7. Një mesazh për bashkëmoshatarët tuaj brenda dhe jashtë vendit?

Mesazhi im do të ishte që, kudo që janë të marrin kualifikimet e duhura dhe do t'i bëja thirrje që aftësitë e tyre të vijnë dhe t'i kontribuojnë në Shqipëri sepse ata garantojnë një zhvillim të mëtejshëm të vendit, por këtu do të kërkoja që edhe shteti shqiptar të krijojë hapësira më të mëdha për këta të rinj.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL